



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**

*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 12.12.2018, me fillim në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit , salla N-10

**PROCESVERBALI**

**Në mbledhje morën pjesë:** Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Duda Balje, Slobodan Petroviç dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Igor Simiq, Haxhi Shala, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Milosavjeviç dhe Zoran Mojsiloviç.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic OSBE; Pleurat Kurti EUSR; Hajrudin Skënderi Ambasada e Suedisë; Ndriçim Çekaj KDI; Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, Zëvendëskryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit me datë 24.10.2018 dhe 15.11.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/22 për Kinematografinë, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi;

6. **Shqyrtimi i Projektligji nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
8. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës.**

**Zëvendëskryetari, Xhelal Sveçla**, në mos praninë e Kryetarit të Komisionit, Igor Simiq, kam ftuar mbledhjen e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me datë 12.12.2018, duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 1, nenin 64 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe me Vendimin e Kuvendit të Kosovës nga data 25.10 dhe 02.11.2018, me qëllim të përshpejtimit dhe miratimit të projektligjeve.

Në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Kosovës, komisioni duhet t'i shqyrtojë brenda afatit të caktuar projektligjet, si në vijim.

Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/22 për Kinematografinë, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi; Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi; Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi; Shqyrtimi i Projektligji nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa; Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa.

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi propozimin e pikëve të rendit të ditës, me qëllim që të shqyrtohen projektligjet ku do të paraqes raport me rekomandime, të cilat do ti procedojë për miratim në komisionet funksionale.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, më datë 24.10.2018 dhe 15.11.2018.**

*Zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni unanimisht miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24.10.2018 dhe 15.11.2018, pa vërejtje.*

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/22 për Kinematografinë, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/22 për Kinematografinë dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

#### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr. 06/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/22 për Kinematografinë dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

#### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.06/L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat, me raport amendamente të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

#### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.06/L-121 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-097 për Bibliotekat dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

## **6. Shqyrtimi i Projektligji nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.06/L-104 për tatimin në të ardhurat personale dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

## **7. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa.**

**Zëvendëskryetari** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

*Pasi nuk kishte vërejtje plotësuese në projektligj dhe në raportin me amendamente të komisionit funksional, komisioni nxori këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

Projektligji nr.06/L-105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, dhe amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

## **8. Të ndryshme.**

**Zëvendëskryetari**, hapi temën e cila ka të bëjë me rastin e ndalimit të jashtëligjshëm të deputetit dhe anëtarit të Komisionit, Slobodan Petroviç, nga ana e xhandarmërisë serbe në kufirin Kosovë-Serbi, përkatësisht në pikën kufitare në Mendarë.

Mes tjerash, gjatë kalimit të kufirit Kosovë-Serbi, deputeti i Partisë Liberale Serbe, Slobodan Petroviç, është ndaluar nga policia serbe ku është mbajtur për disa orë duke u marrë në pyetje nga pjesëtarë të shërbimit informativ serb (BIA). Për orë të tëra deputeti Slobodan Petroviç i është nënshtruar presionit direkt të Serbisë për punën e tij, në cilësinë e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Pas diskutimeve, Komisioni Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

### **DEKLARATË**

1. Dënojmë ashpër ndalimin e paligjshëm të deputetit dhe anëtarit të Komisionit Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve nga policia serbe. Konsiderojmë se ky ndalim bëhet me qëllim të ushtrimit të presionit dhe kërcënimit ndaj punës së deputetit, Slobodan Petroviç.
2. Kërkojmë nga institucionet e Kosovës që të ndërmarrin hapat e nevojshëm që situata të këtilla presioni ndaj deputetëve të mos ndodhin.
3. Kërkojmë nga Zyra për politikë të jashtme e BE-së, përkatësisht nga përfaqësuesja Federica Mogherini që të ushtrojë presion tek Qeveria Serbe për sqarimet e nevojshme mbi arsyen dhe rrethanat e këtij rasti si dhe presionin në mënyrë që të parandalohen rastet e tilla në të ardhmen.
4. Kërkojmë nga institucionet e sigurisë së shtetit të Kosovës që me seriozitet ta trajtojnë këtë rast dhe të ofrojnë siguri për deputetin Slobodan Petroviç dhe familjen e tij.

Në fund, rekomandohet që Deklarata ti dërgohet: Kryesisë së Kuvendit; Zyrës së Kryeministrit; Zyrës së BE-së dhe Policisë së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

Përgatitur nga:  
Njësia për mbështetjen e komisionit.

**Zëvendëskryetar i komisionit,**

---

**Xhelal Sveçla**